

TRIBUNA SINDIKALE

Maj 2008

*Dhe drit e diturisë
përpara do na shpjerë*



Editorial**PSE MESUESIT SINDIKALISTE DUHET
TE PERFITJNE DERI DY PAGA KUR
DALIN NE PENSION**

Ne procesin e negocimeve per nenshkrimin e Kontrates Kolektive te Punes, Sindikatat e Arsimit jane kujdesur qe te sigurojne nga punedhenesi perfitime te merituar dhe te ligjshme per mesuesit dhe punonjesit e sistemit te arsimit ne pergjithesi dhe per anetaret e tyre vecanerisht. Keto perfitime, qofte ato qe lidhen me pagat e shperblimet apo me kushtet, kohet e punes dhe te pushimit, me kualifikimin profesional apo lirite sindikale, etj, kane qene gjithnje dhe jane edhe sot te argumentuara, te bazuara nga pikepamja ligjore, te justifikuar dhe te merituar me perkushtimin, pasionin, kontributet, aftesite dhe energjite qe mesuesi gjate gjithje jetes se tij ia ka kushtuar nje ceshtjeje kaq fisnike, sic eshte arsimimi i brezit te ri.

Nje nga keto perfitime qe Sindikatat e Arsimit kane siguruar per anetaret e tyre nepermjet Kontratave Kolektive te Punes qe kane nenshkuar me MASH keto 6 vitet e fundit eshte edhe dhenia, (me autorizimin e sindikatave), deri ne 2 paga shperblim mesuesve qe dalin ne pension.

Por zbatimi i kesaj dispozite te Kontrates Kolektive te Punes, duke filluar nga shtatori i vitit te kaluar, po pengohet nga Udhezimi i Ministris te Financave Nr. 21 date 18.09.2007 Per "Zbatimin e VKM nr. 369 date 13.6.2007 " Per Fondin e Vecante ne Institucionet Buxhetore". Ne piken 5 te ketij Udhezimi, ku behet fjale per ndihma te menjehershme per raste fatekeqesish dhe raste te tjera, thuhet se ne "rastet e daljes se punonjesve ne pension ndihma jepet ne masen e nje page mujore".

Kjo pike e Udhezimit, persa i perket sektorit te arsimit parauniversitar, vjen ne kundershkrim te hapur me Nenin 8, pika 13 te Kontrates Kolektive te Punes. Mospajtimi qendron si ne permbajtjen e akteve te ballafaquara, ashtu edhe ne hierarkine e normave te se drejtes ne fushen e marredhenieve te punes.

Nga permbajtja, mospajtimi vjen se ndersa dispozita e Kontrates Kolektive te Punes flet per nje shperblim qe jepet per sindikalistet mesues per kontributin dhe vlerat qe ata kane dhene gjate gjithje jetes se tyre per edukimin e brezit te ri, Udhezimi i Ministris te Financave e konsideron kete si nje ndihme, si nje ngushllim per raste fatekeqesish dhe raste te tjera te krahasuara me to.

Nga hierarkia e normave te se drejtes ne fushen e marredhenieve te punes,

mospajtimi qendron ne faktin se Kontrata Kolektive e Punes, ne baze te Ligjit nr. 7961 date 12.7.1995 " Per Kodin e Punes te Republikes se Shqiperise" renditet ne burimin e normave te se drejtes, (shih Neni 11 i Kodit te Punes), dhe kur ne kontrate ka zgjidhje qe jane ne favor te punonjesve, atehere dispozita perkatese e saj fiton prioritet mbi cdo dispozite tjeter ligjore, (pika 3 e Nenit 11 te Ligjit te sipercituar).

Praktika e dhenies nga sindikatat te nje shperblimi deri ne 2 paga mujore mesuesve sindikaliste qe dalin ne pension zbatohet qe nga fillimi i vitit 2002 dhe eshte perfshire si norme ne Kontratate Kolektive qe jane nenshkuar deri me sot. Ne Kontraten Kolektive te Punes te nenshkuar me 4 korrik 2006, midis Ministris te Arsimit dhe Shkences dhe Kryetareve te FSASH e SPASH, ne Nenin 8, pika 13 thuhet: "Me autorizim me shkrim nga sindikatat nenshkruese te kesaj Kontrate Kolektive, mesuesit qe dalin ne pension perfitojne deri ne 2 paga mujore shperblim..."

Ky perfitim, bazuar ne Nenin 114, pika 2 te Kodit te Punes, nuk mund te kundershohet ose mohohet nga askush, sepse ligji e thote qarte se kur punedhenesi paguan nje shperblim tre vjet rresht pa rezerva te shprehura, atehere eshte i detyruar te vazhdoje pagimin edhe ne te ardhmen.

Ne keto kushte, Sindikatat e Arsimit kane kerkuar dhe vazhdojne te kerkojne me kembengulje nga Ministria e Arsimit dhe Shkences, nga Ministria e Financave dhe Qeveria sqarimin dhe zgjidhjen e mospajtitimit qe eshte krijuar nga Udhezimi Nr. 21 date 18.09.2007 te Ministris te Financave per dhenien nga ana e sindikatave deri ne 2 paga per mesuesit qe dalin ne pension.

Per palen e punedhenesit duhet te jete e qarte se FSASH dhe SPASH do te presin deri me 10 qershor per te gjetur zgjidhje nepermjet dialogimit. Ne te kundert, ato jane te gatshme te ndermarrin veprimet qe kane ne dispozicion per mbrojtjen e arritjeve sindikale qe kane siguruar ne rruge ligjore me Kontrate Kolektive.

E drejta e Sindikatave per t'u dhene mesuesve anetare te tyre qe dalin ne pension, nje shperblim deri ne masen e 2 pagave mujore, e drejte e siguruar ne rruge dhe me mjete ligjore, nuk mund te anulohet nga askush.

PERMBAJTJA

Editorial:

- ✓ Pse mesuesit sindikaliste duhet te perfitojne deri dy paga kur dalin ne pension **2**
- ✓ Tryeza mbi koordinimin e veprimeve per eliminimin e punes se femijeve **3**
- ✓ Konkluzione te Anketimit mbi punen e FSASH/SPASH me grate mesuese **8**
- ✓ Aktivitete ne kuadrin e Javes se Veprimeve Globale per Arsimin, (21-27 prill) **12**
- ✓ Diskutim per Kodin i Etikes per mesuesit **13**
- ✓ Mbi reformen e sistemit te zhvillimit profesional te mesuesve **14**
- ✓ Te reja shkencore dhe Keshilla praktike **15**

Kopertina e pare:

Nga Tryeza per angazhimin e sindikatave, Qeverise dhe aktoreve te tjere per eliminimin e punes se femijeve.

Kopertina e fundit:

Nga aktivitetet e organizuara ne kuadrin e Javes se Veprimeve Globale per Arsimin, (GAW), 2008

**TRIBUNA SINDIKALE
Nr. 34, Periodike**

*Botim i FSASH dhe SPASH
Me mbeshtetjen financiare te
Konfederates se Sindikatave
te Holandes, FNV*

ADRESA:

*Rruga "Dora D'Istria", Pallati Perballe
Fakultetit Juridik, Kati i 3-te, Tirane
Tel & Fax + 355 4 225 65 32
Celular: + 355 68 20 34 674,
+ 355 69 22 69 795, + 355 68 21 52 891
E-mail: fsash@abcom-al.com
Internet: www.fsash-spash.com*

Keshilli Botues:

*Xhafer Dobrusha,
Bajram Kruja,
Lumturi Mataj,
Defrim Spahiu,
Petref Çelaj,
Aleks Dushi,
Stavri Liko, Kryeredaktor*

Tryeze mbi koordinimin e veprimeve per eliminimin e punes se femijeve

Në vazhdim të aktiviteteve tona të mëparshme, në lidhje me angazhimin e sindikatave të degëve të tjera në parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve, një Tryezë e Rrumbullakët e nivelit të lartë u organizua në Tiranë në 25 dhe 26 prill nga FSASH dhe SPASH, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Më shumë se 50 përfaqësues nga të dy qendrat e sindikatave Shqiptare, KSSH dhe BPSH, ku FSASH dhe

sindikatave, organizatat e punëdhënësve, organet shtetërore, veçanërisht ato që veprojnë në kuadër të Ministrisë së Punës, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe aktorë të tjerë që të marrin pjesë në këtë angazhim.

Ministri i PCSSHB, Zoti Kosta Barka, në fjalën e vet, pasi vlerësoi iniciativën dhe angazhimin e dy sindikatave të arsimit për eliminimin e punës së femijeve, u ndal në menyre të

ketyre femijeve i sigurova punësim.

Në vijim, zoti Kosta Barka evidentoi disa nga prioritetet e Ministrisë që ai drejton, duke nenvizuar sidomos, permiresimin e legjislacionit kombëtar dhe harmonizimin e tij me standardet nderkombetare, bashkëpunimin e aktoreve të ndryshëm me Inspektoriatin Shtetëror të Punës, Institucionalizimin e Monitorimit të Punës së Femijeve, rritjen e efektivitetit të Komitetit Drejtues Kombëtar, të Njesisë së Punës së Femijeve pranë kësaj Ministrie etj.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Zoti Genc Pollo, mbasi pershendeti të pranishmit dhe organizatoret e Tryezës, foli për angazhimin e MASH dhe bashkëpunimin me sindikatat e arsimit për parandalimin dhe eliminimin e punës së femijeve. Ai vlerësoi si përvore të mirë ndjekjen në vazhdimësi të këtij problemi nga ana e të dy partnereve dhe përqendrimin në rrethë, zona dhe shkolla konkrete, duke përfshirë në këtë levizje qindra e qindra mesues sindikaliste, drejtues shkollash, nxenes dhe prinder si dhe aktore të tjera të interesuar për një arsim cilësor dhe shanse të barabarta për të gjithë.

Zoti Pollo theksoi se gjatë ketyre 2-3 viteve ka ndjekur nga afer dhe ka marrë pjesë në veprimtaritë e shumta që kanë organizuar sindikatat e arsimit për parandalimin e punës së femijeve, për kthimin në shkollë të nxenesve që e braktisin atë dhe për nxjerrjen nga rreziku i braktisjes të qindra të tjerëve. Ai e konsideroj këto levizje të sindikatave të arsimit si një konceptim dhe pozicionim të ri të tyre, si lidhje konkrete e objektivave sociale ekonomike me objektivat për reformimin dhe modernizimin e arsimit.

Ministri Pollo shfaqti edhe një herë gatishmerinë e MASH për të bashkëpunuar ngushtë me sindikatat në funksion të plotësisht të synimeve e qëllimeve të përbashkëta, krijimit të një sistemi arsimor të reformuar e modernizuar.



SPASH janë anëtare, si dhe nga MPCSSHB dhe MASH, morën pjesë në ditën e parë të Tryezës së Rrumbullakët të organizuar në Tiranë në Tirana International Hotel, **për të diskutuar "si të punojmë së bashku për t'i mbajtur fëmijët në shkollë dhe për të eliminuar punën e fëmijëve"**.

Kryetari i Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës, Zoti Xhafer Dobrushit, foli në emër të të dy sindikatave të arsimit për angazhimin e tyre në parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve duke kërkuar edhe përfshirjen e degëve të tjera të

vecante në ceshtjen e angazhimit të organeve shtetërore dhe bashkëpunimit midis shumë aktoreve që veprojnë në fushën e parandalimit dhe eliminimit të punës së femijeve. Ai parashtrij arritjet e shënuara në kuadrin e projektit mbi sistemin e Monitorimit të Punës së Femijeve, të zbatuar nga MPCSSHB, në bashkëpunim me ILO-IPEC në Tiranë, dhe tha se në saj të këtij Projekti u mundësua që të kthehen në shkollë 54 femije, ndërsa 26 të rinjë ose pjesëtarëve të familjeve të femijeve të angazhuar në punë iu sigurova formim profesional, ndërsa 57 prinderve të

Vijon nga faqja 3

Zëvendës Ministria e Puneve te Brendshme, Zonja Iva Zajmi, i njohi te pranishmit mbi punen qe bejne strukturat shtetore dhe vecanrisht Ministria e Puneve te Brendshme kunder trafikimit te qenieve njerezore, perfshire edhe trafikimin e femijeve. Ajo e vuri theksin te nevoja per nje bashkepunim me efektiv midis gjithë strukturave dhe aktorve qe merren me parandalimin e punes se femijeve dhe garantoi se dikasteri qe ajo perfaqeson do t'i plotesoje detyrimet e veta ne kuadrin e Komitetit Kombetar te Mbrojtjes se Femijeve.

Të dy presidentët, ai i BSPSH, Zoti Gëzim Kalaja dhe ai i KSSH, Zoti Kolë Nikollaj, të pranishëm në Tryezën e Rrumbullakët, vlerësuan punën e bërë nga FSASH dhe SPASH dhe shprehën qëllimin dhe gatishmerine e tyre për të qenë të angazhuar më konkretisht dhe për të koordinuar më mirë punën me sindikatat e profesioneve anëtare të të dy konfederatave, në mënyrë që të fuqizohet e masivizohet fronti sindikal për eliminimin e punës së fëmijëve në Shqipëri.

Në emër të ITUC dhe FNV, Zoti Samuel Grumiau foli për angazhimin e tyre në eliminimin e punës së fëmijëve në Shqipëri, duke mbështetur drejtpërdrejtë të dy Konfederatat dhe veçanërisht sindikatat e arsimit, duke përmendur misionin dhe raportin e Konferencës së Tetorit 2004, Konferencën Rajonale në Tetor 2006 dhe zbatimin aktual të projektit.

Përfaqësues nga organizatat e punëdhënësve dhe aktorë të tjerë, gjithashtu, shprehën mendimin e tyre mbi punën e bërë dhe veprimet qe duhen ndërmarrë së bashku per te patur rezultate konkrete në identifikimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve në Shqipëri.

Argumenti kryesor i diskutuar në këtë seancë ishte të punuarit së bashku, sindikata dhe organe shtetërore, duke informuar njëri tjetrin, duke u marrë konkretisht me ngritjen e problemeve, duke përfshirë të gjithë aktorët e interesuar, përfshirë këtu edhe vetë fëmijët dhe prindërit e tyre.

Si rezultat, një Marrëveshje e Përbashkët u përpunua, diskutua dhe aprovua në këtë Tryezë me pjesëmarrjen e 12 përfaqësuesve sindikale, 3

perfaqësuesve të organizatave te punedhenesve si dhe Inspektoriatit Shtetëror të Punës, Drejtorisë se Politikave te Punesimit dhe Drejtorisë se Shërbimeve Sociale në Ministrinë e Punës.

Në ditën e dytë, punimet e Tryezes u zhvilluan në sallën e mbledhjeve pranë Qendrës së Sindikatave të Arsimit, u diskutua midis vetë sindikatave duke synuar promovimin, mbështetjen dhe përfshirjen e disa prej degëve të tjera të sindikatave në aktivitetet e eliminimit të punës së fëmijëve.

Në një prezantim të mbajtur në emër të të dyja sindikatave, FSASH dhe SPASH, disa pika të rëndësishme në lidhje me mësimet e marra nga eksperienat e tyre u parashtruan, duke përmendur fillimisht nevojën e të paturit sindikata të forta dhe të mirëorganizuara, detyrimin për të futur parandalimin dhe

përqendruar si Tirana, Elbasani, Korca, Fieri, Shkodra, Durrësi etj.

Presidenti i KSSH, Kole Nikollaj, dhe përfaqësues nga sindikata të tjera anëtare (Tekstil, Veshmbathje dhe Artizanat; Industria e Lehtë; Ndërtimi; Bujqësia etj) morën pjesë aktivisht në diskutim, duke shprehur mendimet e tyre se si të punohet konkretisht per te parandaluar dhe eliminuar punen e femijeve, gjë që nuk është kryer mirë deri tani.

Shumica e tyre përmendën probleme që ekzistojnë, veçanërisht në disa kompani që punojnë me materiale të para të blera nga jashtë dhe që prodhojnë për eksport me çmime shumë të ulta, duke shprehur nevojën për më shumë mbështetje edhe nga sindikata të vendeve që blejnë produktet, veçanërisht ato Italiane.

Zoti Samuel Grumiau, prezantoi



eliminimin e punës se fëmijëve në axhendën e tyre, si të punojnë në skuadër me partnerë të tjerë, duke përdorur marrëveshjen kolektive si një mjet të rëndësishëm për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve, komunikimin me aktore të tjerë etj. Në vijim, shefja e Njësisë së Eliminimit të Punës së Fëmijëve, ne MPCSSHB znj. Shkëlqesa Manaj, parashtror punën që ben Njesia dhe u ndal posacerisht ne mënyrat e mundeshme për të bashkëpunuar më mirë me sindikatat, veçanërisht në nivel lokal, duke veçuar rajonet ku sindikatat e arsimit janë

angazhimin konkret të ITUC dhe FNV në Shqipëri, perfshire edhe problemet qe krijohen nga kompanite e huaja qe ofrojne material per te punuar dhe blejne fuqine e lire punetore ne Shqiperi dhe nguli këmbë në shmangien e ketij fenomeni nepermjet te punuarit së bashku jo vetëm si sindikata, por edhe me aktorë të tjerë, duke përdorur edhe eksperiençën e FSASH dhe SPASH.

Pas diskutimeve konstruktive, një plan veprimi dhe një Thirrje për Lëvizjen Ndërkombëtare të Sindikatave u aprovuan nga pjesëmarrësit ne Tryeze.

Ne front te perbashket per eliminimin e punes se femijeve ne Shqiperi

Nga Fjala Hyrese e z. Xhafer DOBRUSHI, ne mer te FSASH dhe SPASH

Ne ditet e sotme puna e femijeve pothuaj ne te gjithë vendet e botes vazhdon te shfaqet ne permasa shqetsuese dhe mbetet nje pengese serioze ne rrugen e zhvillimit dhe progresit te jetes shoqerore ekonomike te popujve. Prandaj themi se lufta kunder punes se femijeve na perket te gjithëve. Te gjithë ne, ne veprimtarine tone, ne nje menyre ose ne nje tjetër, jemi te lidhur me te dhe te gjithë kemi pjesen tone te pergjegjesise pse ajo ekziston dhe pse nuk eliminohet. Ketej rrjedh kerkesa qe, Qeverite, punedhenesit, sindikatat, organizatat nderkombetare, shoqeria civile, mesuesit, punetoret sociale, prinderit, vete femijte duhet te angazhohen, te marrin pergjegjesi dhe te luajne rolin e tyre per eliminimin e kesaj plage shoqerore.

Federata e Sindikatave te Arsimit dhe Shkences dhe Sindikata e Pavarur e Arsimit Shqiptar u angazhuan dhe perfshine te parat ne luften kunder punes se femijeve 6-7 vjet me pare. Kjo perfshirje nuk ishte e rastit. Ajo kushtezohet nga dy faktore.

Se pari, mbas nje ekzistence pothuajse 10 vjecare, FSASH dhe SPASH munden te konsolidojne, (fale edhe bashkepunimit midis tyre), pozitat ne fushen e mbrojtjes se kerkesave sociale ekonomike te anetareve qe perfaqesonin dhe gjithë mesuesve. Nepermjet negocimit dhe nenshkrimit te kontratave kolektive te punes ato arriten te institucionalizojne marredheniet me Ministrine e Arsimit e Shkences dhe, kur ka qene rasti, edhe me Qeverine, duke bere te mundur nje dialog social pothuaj te vazhdueshem dhe efektiv. Kjo na mundesoi qe te krijojme nje vizion me largpames per funksionet dhe obligimet e sindikatave, per rolin dhe vendin e tyre ne procesin e reformimit dhe modernizimit te arsimit ne vendin tone.

Se dyti, nga ky stad, nga keto pozita, ne filluam t'i shikojme kerkesat dhe mbrojtjen e interesave sociale ekonomike te anetareve, qe perben funksionin themelor te nje sindikate, te kushtezuar me angazhimin e sindikatave ne procesin e reformimit e modernizimit te arsimit, me rezultatet e ketij procesi dhe me shkallen e progresit te vendit dhe shoqerise. Kjo i ka bere dhe i ben kerkesat tona para punedhenesit me te ekuilibruara, me te argumentuara dhe me te mundshme per t'u plotesuar, kryesisht nepermjet dialogut.

Duke mbeshtetur dhe marre pjese ne procesin e reformimit te arsimit ne u ndeshem, midis te tjerave, edhe me problemin e femijeve qe braktisin shkollen ose me kontigjente te konsiderueshme nxenesish qe ishin dhe jane ne rrezik per ta braktisur.

Ne arsim eshte me e dukshme lidhja qe ekziston midis fenomenit te largimit te nxenesve nga shkolla me punen e femijeve. Me ndonje perjashtim te rralle, femijte qe punojne, qofshin keta ne ndertim, ne bujqesi, ne industrine e lehte, ne tekstile, ne tregeti, ata qe shesin ne rruge, germojne ne plehra, lajne makina, apo lipin, jane te moshes shkollore, jane nga ata qe i perfshine arsimi i detyruar, jane nga ata qe vendin e kane ne shkollë dhe jo ne pune.

Per shkak te veshtiresive qe shoqeruan periudhen e tranzicionit, te levizjeve te medha te popullsisë, numri i nxenesve braktises ne periudhen e pare te viteve 90-te arrinte ne disa rrethe deri ne 5 perqind te numrit te pergjithshem te nxenesve. Sot ky numer ne shkallë vendi eshte rreth 1 perqind, ose me konkretisht 6000 - 7000 nxenes braktisin shkollen cdo vit, ndersa rreth 30.000 deri 40.000 te tjere frekutojne me nderprerje me ore, me dite ose me jave, pra jane brenda rrethit te rrezikut te braktises.

Sindikatat tona jane marre drejtperdrejt me kete problem. Fillimisht, me ndihmen e Programit Nderkombetar per Eliminimin e Punes se femijeve, me te cilin kemi bashkepunuar dhe bashkepunojme edhe sot, ne pergatitem me disa seminare 3 ditore 24 trajnues te trajnuesve, te cilet gjate viteve 2001-2008 kane trajnuar ne shkallë rrethi dhe drejtperdrejt ne shkollë disa qindra mesues sindikaliste, qe sot punojne me nje larmi formash me nxenes e prinder, qe bashkepunojne me drejtorite dhe me gjithë komunitetin e shkolles, me pushtetin vendor, dhe tashme perbejne nje force reale per kthimin ne shkollë te femijeve braktises dhe nxjerrjen jashte rrezikut te atyre qe mund te braktisin, duke ulur ne menyre te ndjeshme numrin e femijeve qe punojne.

Me kete rast, falenderojme Federaten Nderkombetare te Arsimit, EI, Konfederaten Holandeze dhe Sindikaten e Arsimit te Holandes AOb, per mbeshtetjen e vazhdueshme qe na kane dhene, qofte financiare dhe profesionale

me lektore te kualifikuar e pervoje te pasur, gje qe na ka mundesuar ne sindikatave shqiptare te arsimit te krijojme kapacitetet e nevojshme dhe te jemi efektive ne luften kunder punes se femijeve.

Edhe ne kuadrin konfederativ perpjekjet per t'i perfshire sindikatat e degeve dhe profesioneve ne luften kunder punes se femijeve kane disa vjet qe kane filluar. Mbas disa veprimtarive qe sindikatat e arsimit kane zhvilluar me sindikata te degeve e profesioneve te tjera per t'i mbeshtetur ato qe te angazhohen ne luften kunder punes se femijeve, ne tetor 2004 u zhvillua ne Tirane Konferenca e ICFTU, sot ITUC, mbi rritjen e angazhimit te KSSH e BSPSH per eliminimin e punes se femijeve.

Kjo Conference shenoi nje pike kthese ne krijimin e opinionit per domosdoshmerine e perfshirjes se te gjitha sindikatave ne parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve, sidomos nepermjet negocimeve me punedhenesin dhe nenshkrimin e kontratave kolektive te punes. Keta muajt e fundit ne kemi organizuar disa konsultime te perbashketa me koleget drejtues te sindikatave te degeve dhe profesioneve te tjera dhe si rrejdhoje, ka nje gatishmeri per nje angazhim me te efektshem e frutdhenes ne veprimtarite per eliminimin e punes se femijeve.

Nje ndihmese ne punen e te gjithë sindikatave tona kane qene vrojtimet e hollesishme dhe studimet qe kolegu yne, Samuel Grumiau, ka bere per punen e femijeve ne Shqiperi, duke shkuar ne ndermarrje e kompani konkrete, bile edhe ne familje dhe duke i pasqyruar keto ne shtypin e ITUC. Ne gjejme rastin ta falenderojme per kete kontribut.

Ne kemi shkembyer mendime edhe me shumicen e aktoreve jo sindikale, qe jane te pranishem ne kete Tryeze. Ata do te evidentojne angazhimet dhe obligimet e tyre dhe ne fund, te gjithë ne se bashku, do te nenshkruajme nje marreveshje shoqerore per te bashkerenduar e bashkevepruar veprimtarite per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve. Qellimi yne eshte qe te krijojme nje front te perbashket solid dhe sa me te qendrushem per te luftuar me efektshmeri dhe per te eliminuar punen e femijeve ne Shqiperi.

Vijon nga faqja 5

MARREVESHJE

Ne Tirane, sot me daten 25 prill 2008, ne titullare dhe perfaqesues te Institucioneve dhe Organizatave te interesuara dhe te angazhuara per mbrojtjen e te drejtave te femijeve, te mbledhur ne nje Tryeze **Per angazhimin e Sindikatave, organizatave te punedhenesve dhe aktoreve te tjere per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve ne Shqiperi;** mbasi diskutuam per gjendjen dhe permasat shqetsuese te ketij fenomeni, te ndergjegjshem per rendesine dhe ndikimin qe ka eliminimi i punes se femijeve ne gjithe procesin e progresit shoqeror ne vend, te vetdijshem se perballimi dhe crenjosja e kesaj plage nga shoqeria nuk mund te arrihet kurre pa punen dhe bashkeveprimin e shume aktoreve, e pame te arsyeshme dhe te nevojshme qe te arrijme ne nje Marreveshje shoqerore, ne te cilen, secili aktor vec e vec, sipas specifikave perkatese, merr persiper angazhime dhe detyrime te caktuara, te cilat, te marra se bashku, krijojne nje front aktoresh qe do te ndikojne fuqishem ne parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve.

Subjektet pjesemarrese ne Tryeze, hartues dhe zbatues te kesaj Marreveshjeje, i konkretizuan kontributet dhe obligimet e tyre ne kete Front te perbashket si vijon.

1. Grupi i sindikatave ne perberje te KSSH e BSPSH: Federata e Sindikatave te Arsimit dhe Shkences, Sindikata e Pavarur e Arsimit Shqiptar, Federata Sindikale e Tekstil- Artizanatit, Sindikata e Pavarur e Industrise se Lehte, Sindikata e Pavarur e Ndertimit dhe Sherbimeve Publike, Federata e Sindikatave te Ndertim- Drurit dhe Sherbimeve Publike, Federata e Sindikatave te Shendetsise, Sindikata e Pavarur e Bujqesise, Sindikata e Pavarur e Kimi-Metalurgjise dhe Federata e Sindikale e Punonjesve Civil te Mbrojtjes; si dhe

Sindikata e Pavarur e Tekstil-Konfeksioneve e Lekures dhe Federata Sindikale e Tregtise Bankave dhe Sherbimeve, marrin persier:

-Evidentimin dhe organizimin e punes per uljen e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen, ose jane ne rrezik per ta braktisur ate.

-Ndermarrjen e veprimeve konkrete mbi baze rrethi dhe shkolle per rikthimin dhe integrimin e nxenesve braktises ne shkolle.

-Bashkeveprimin me DAR e ZA dhe drejtorite e shkollave, me komunitetin e prinderve dhe nxenesve per te krijuar nje opinion dhe mobilizim per rezultate me cilesore ne shkollat dhe eliminimin e punes se femijeve.

-Sindikatat e degeve sipas profesioneve perkatese, ne bashkepunim me sindikatat e arsimit dhe partnere te tjere angazhohen te trajnojne veprimtare e drejtues te tyre sindikaliste per t'ipergatitur qe te perballojne problemet qe lidhen me punen e femijeve ne sektorin ku ata punojne.

-Sindikatat e degeve dhe profesioneve gjate negociimeve per kontratat kolektive te punes te perfshijne ceshtje qe lidhen me ndalimin e punes se femijeve nga punedhenesit e tyre.

-Te kordinojne me mire veprimet me Sherbimin Kombetar te Punesimit dhe Inspektoriatin Shtetror te Punes per procedurat e regjistrimit ligjor te marrjes ne pune te punonjesve.

-Ne bashkepunim me sindikatat te angazhohen per te gjetur menytrat e shmangies se pjesemarrjes se femijeve ne punet me porosi ne familje.

3. Inspektoriati Shtetror i Punes:

merr persiper:

- Te shkembeje informacion me sindikatat ne lidhje me punesimin e femijeve.

- Te ndjeke me perparesi rastet e punesimit te femijeve te denoncuar nga sindikatat duke bashkepunuar me to deri ne zgjidhjen e problemit.

- Ne bashkepunim me sindikatat e



-Sindikatat e degeve dhe profesioneve do te evidentojne rastet kur ka punesim te femijeve ne sektoret e tyre dhe, krahas diskutimit te problemit me punedhenesin, kur nuk arrihet zgjidhje e menjehershme, do te vene ne dijeni Inspektoriatin Shtetror te Punes.

2. Grupi i punedhenesve: Shoqata e ndertuesve te Shqiperise, Keshilli i Organizatave te Punedhenesve te Shqiperise dhe Shoqata e Prodhuesve Eksportues te Konfeksioneve prej Tekstili: marrin persiper qe:

- Te nderhyjne ne sipermarrjet private qe, duke shmangur informalitetin ne punesim, nepermjet sigurimit te punonjesve, te eliminojne punesimin e femijeve.

arsimit, do te ndikojne per te mundesuar perfshirjen ne oret ekstrakurrikulare te disa temave te vecanta, qe perbejne standarde, mbi rregullat dhe sigurimin ne pune.

4. Drejtoria e Politikave te Punesimit prane MPCSSHB:

merr persiper qe:

- Zyrat e punesimit te ndjekin me pergjegjesi regjistrimin e gjithe kerkesave per punesim dhe, ne bashkepunim me ISHP, te kontrollojne procedurat e punesimit sipas kerkesave dhe standardeve te percaktuara.

- Nepermjet Qendrave te Formimit Profesional, te organizojne trajnime me te rinje te reja per t'i njohur ata me kerkesat e tregut te punes dhe per t'i orientuar drejt profesioneve me te kerkuara.

5. ILO-IPEC:

Do të mbeshtese angazhimin e sindikatave dhe partnereve të tjere nepermjet:

- Ofritim të informacionit të nevojshem mbi fenomenin e punës së femijeve.

- Ofritim të informacionit mbi praktikat me të mira të bashkepunimit me Sindikatat për parandalimin dhe eliminimin e punës së femijeve.

- Asistencës dhe kontributit për krijimin e kapaciteteve të sindikatave për t'iu

pergjigjur me mire nevojës për të parandaluar dhe eliminuar punën e femijeve.

- Përfshirjes së sindikatave në aktivitetet e IPEC në Tiranë e në mënyrë të vecante në fushatë sensibilizuese për eliminimin e punës së femijeve.

Tiranë, më 25 prill 2008

Thirrje e Sindikatave Shqiptare drejtuar Levizjes Sindikale Nderkombetare

- Duke marrë në konsideratë që puna e femijeve vazhdon të jetë një problem serioz në Shqipëri, duke përfshirë kompanitë që eksportojnë prodhimet e tyre kudo në botë, si ato të prodhimit të kepuceve e veshjeve, të cilat punojnë me kompani të huaja, si edhe sektorin e tregtisë, bujqësisë, ndërtimit etj,

- Duke marrë në konsideratë konkluzionet e Konferencës mbi Punën e Femijeve që është organizuar, në bashkëpunim me Konfederatën Nderkombetare të Sindikatave, (ITUC), në tetor 2004 (të cilat janë bashkëngjitur), si edhe Marrëveshjen midis sindikatave, organizatave të punëdhënësve, institucioneve respektive qeveritare dhe aktoreve të tjera, të nënshkruar në përfundim të Tryezës së organizuar në Tiranë në datat 25 dhe 26 prill 2008,

- Duke marrë në konsideratë mesimet e nxjerra nga Projektet kundër punës së

femijeve të zbatuara nga dy sindikatat shqiptare të arsimit, FSASH dhe SPASH, që nga viti 2001 (me mbështetjen e ILO-IPEC dhe ITUC) dhe nga viti 2004 e në vijim, (me mbështetjen e FNV dhe sindikates holandeze të mesuesve, AOb),

Të mbledhur sot në Tiranë në një Tryezë me synim për të përfshirë sa më shumë sindikata të degeve të tjera në luftën kundër punës së femijeve:

Në nënshkruarit e kësaj Thirrjeje, drejtues të Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës, Sindikatesë e Pavarur të Arsimit Shqiptar, Federatës Sindikale të Tekstil- Artizanatit, Sindikatës e Pavarur të Industrisë së Lehtë, Sindikatës e Pavarur të Ndërtimit dhe Sherbimeve Publike, Federatës së Sindikatave të Ndërtimit- Drurit dhe Sherbimeve Publike, Federatës së Sindikatave të Shëndetsisë, Sindikatës e Pavarur të Bujqësisë, Sindikatës e Pavarur të Kimi-Metalurgjisë dhe Federatës së Sindikalës

e Punonjësve Civil të Mbrojtjes; si dhe Sindikata e Pavarur të Tekstil- Konfeksioneve të Lekurës dhe Federatës Sindikale të Tregtisë Bankave dhe Sherbimeve,

I drejtohem i levizjes sindikale ndërkombetare me kërkesën për të ndihmuar në veprimet tona kundër shfrytëzimit të femijeve, sidomos në kompanitë e industrisë eksportuese. Në kërkojmë ndihmë sidomos nga sindikatat e vendeve kryesore që blejnë prodhimet e realizuara në vendin tonë, për të na mbështetur në veprimet tona për eliminimin e punës së femijeve dhe mbajtjen e nxënësve në shkollë.

Cfardo lloj mbështetjeje nga sindikatat ndërkombetare ose ato të vendeve që blejnë artikujt e prodhuar në Shqipëri do të ishte një inkurajim i madh për sindikatat shqiptare në luftën e tyre kundër punës së femijeve.

Tiranë, më 26 prill 2008

PLAN VEPRIMI

PER ANGAZHIMIN E SINDIKATAVE SHQIPTARE PER ELIMINIMIN E PUNES SE FEMIJEVE

Perfaqesuesit e FSASH e SPASH, si edhe të degeve e federatave të BSPSH e KSSH:

Federatës Sindikale të Tekstil- Artizanatit, Sindikates së Pavarur të Industrisë së Lehtë, Sindikates së Pavarur të Ndërtimit dhe Sherbimeve Publike, Federatës së Sindikatave të Ndërtimit- Drurit dhe Sherbimeve Publike, Federatës së Sindikatave të Shëndetsisë, Sindikates së Pavarur të Bujqësisë, Sindikates së Pavarur të Kimi-Metalurgjisë dhe Federatës Sindikale të Punonjësve Civil të Mbrojtjes; si edhe:

Sindikates së Pavarur të Tekstil-Konfeksioneve të Lekurës dhe Federatës Sindikale të Tregtisë, Bankave dhe Sherbimeve, pas diskutimeve që u bënë në Tryezën e zhvilluar në Tiranë, në datat 25 dhe 26 prill 2008, në lidhje me angazhimin e tyre për eliminimin e punës së femijeve në vendin tonë, rane dakord që të miratojnë Planin e Veprimit, me detyrat që vijojnë:

1. Të punohet konkretisht për të zbatuar zotimet respektive që janë marrë në Marrëveshjen e Përbashkët me aktoret e tjera, të miratuar në datën 25 prill 2008, në po këto Tryeze.

2. Një herë në 6 muaj të bëhet bilanci i zbatimit të detyrave të percaktuara në këto Marrëveshje, në një Takim me

pjesëmarrjen e të gjithë perfaqësuesve të organizatave pjesëmarrëse në këto Marrëveshje.

3. Brenda një periudhe 2-mujore, të gjitha sindikatat nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje të ndërmarrin të pakten një veprim konkret, duke u përqendruar në 2-3 kompani, duke evidentuar problemet dhe duke filluar një punë konkrete për përmirësimin e situatës.

4. Një herë në 6 muaj, në një Takim të posaçëm, dy grupimet sindikale, BSPSH e KSSH, të bëjnë analizën e ecurisë së angazhimit të tyre dhe të degeve përkatëse për eliminimin e punës së femijeve.

5. FSASH e SPASH, në bashkëpunim me partneret e tyre, (ILO-IPEC dhe EI), të shikojnë mundësinë e organizimit të trajnimeve specifike me perfaqësues të këtyre degeve në lidhje me standardet ndërkombetare për moshën e punësimit dhe angazhimin për eliminimin e punës së femijeve.

6. Të bashkëpunohet me organet e pushtetit lokalë, shoqatat e Bashkive e Komunave etj, për të parë mundësinë e prioritetit në punësimin të familjeve që për shkak të nevojave të mbijetesës i shkepusin fëmijet nga shkolla dhe i detyrojnë ata të punojnë, si edhe për trajnimin pa pagesë të femijeve në nevojë.

Tiranë, më 26 prill 2008

DISA KONKLUSIONE NGA ANKETIMI MBI PUNEN E FSASH E SPASH ME GRATE MESUESE NE SINDIKATE

Puna me grate mesuese, rritja e pjesemarrjes se tyre ne sindikate, permiresimi i pozites se tyre ne arsim dhe trajtimi e zgjidhja e problemeve specifike qe ato kane ne mardheniet e punes, ne jeten shoqerore dhe ne kohen e lire, eshte nje nga drejtimet e rendesishme te veprimtarise se FSASH e SPASH, sidomos ne kuadrin e Projektit qe ato jane duke zbatuar me mbeshtetjen e sindikatave holandeze, FNV dhe AOb.

Per te njohur me mire gjendjen, per te bere nje analize te situates dhe per te percaktuar disa detyra te tjera konkrete ne procesin e realizmit te ketyre objektive, te dyja sindikatat e arsimit ndermores nje Anketim, konkluzionet e te cilit jane ne vijim:

I. DISA TE DHENA E KONKLUSIONE MBI POZITEN E GRAVE NE SINDIKATA E NE ORGANET DREJTUESE TE TYRE SI DHE ADMINISTRATEN E SHKOLLAVE

Po t'u referohemi tabelave perkatese ne lidhje me kete ceshtje, dalin keto te dhena e konkluzione:

- Ne 65 shkolla, ku eshte kryer Anketimi, punojne 2 463 mesues, prej te cileve 1965 jane gra. Pra grate perbejne rreth 80 perqind te numrit te pergjithshem te mesuesve ne keto shkolla, gje qe flet qartazi per rendesine e madhe qe ka angazhimi i te dyja sindikatave per t'u marre me problemet specifike qe ato kane ne shkolle e jasht saj.

- Rreth 35 perqind e ketyre grave mesuese ose 688 prej tyre, jane te moshave te reja, deri ne 34-35 vjec, gje qe krijon premisa per nje rinovim te metejsheem edhe te punes e veprimtarise sindikale ne keto shkolla.

- Edhe persa i perket anetarsimit ne sindikate treguesit jane domethenes. Nga 1965 mesuese te punesuara ne keto shkolla, 1373, ose rreth 70 perqind e tyre, jane anetare te njerës nga sindikatat tona te arsimit, gje qe tregon se eshte bere nje pune e mire nga ana e tyre per te shtuar numrin e grave sindikaliste. Por nje angazhim me i mire i yni per te trajtuar probleme te ndryshme dhe duke shtruar alternativa per zgjidhje, me siguri qe do te ndikonte qe te terhiqnim edhe me shume gra mesuese ne sindikate.

Per rezervat e medha qe kemi ne kete drejtim flasin edhe ndryshimet e ndjeshme qe kemi nga nje shkolle ne tjetren dhe nga nje rreth ne tjetrin. Shembulli me i mire ndermjet rretheve dhe shkollave te anketuara eshte Kucova, ku te gjitha grate mesuese te shkollave ku eshte bere anketimi, 91 gra, jane anetare te njerës nga sindikatat tona. Tregues te kenaqshem rezulton te kene edhe Korca ku 145 nga 153 gra mesuese, ose 95 perqind e tyre jane te anetaresuara ne sindikate, Tirana Qytet, ku 435 nga 598 gra mesuese ose 73 perqind e tyre jane te anetaresuara ne sindikate, Elbasani, qe ka po te njejtin nivel, ku 195 nga 267 gra mesuese jane anetare te njerës nga sindikatat tona.

Me shume pritjet nga komitetet e grave dhe seksionet sindikale te rretheve Tirana Rreth, Durres, Fier etj, ku ky tregues varion nga 45 deri ne 55 perqind.

- Probleme dalin nga analiza e treguesve qe kane te bejne me perfaqesimin e grave ne organet drejtuese te sindikatave. Nga rreth 455 anetare te keshillave sindikale te shkollave ku eshte bere Anketimi, vetem 158, ose rreth 34 perqind, rezulton te jene gra, nderkohe qe ne anetaresi grate zene me shume se 48 perqind te numrit te pergjithshem. Akoma me i ulet eshte ky perfaqesim ne kryesite e seksioneve sindikale te rretheve, ku figurojne te jene vetem 15 gra.

- Megjithte potencialin e madh intelektual dhe angazhimin e perkushtimin qe kane, grate zene

akoma nje perqindje te ulet edhe ne organet drejtuese te administratave te shkollave, sidomos ne postet titullare, ku del qe ne keto 65 shkolla te jene vetem 22 drejtoresha dhe 56 Zv/drejtoresha, nga te pakten 130 qe mund te jete numri i pergjithshem ne keto poste.

Per te permiresuar gjendjen sindikatave u dalin detyra te rendesishme, sidomos per te permiresuar kuadrin ligjor per shanse te barabarta ne sektorin e arsimit, por ne te njejten kohe edhe vete grate mesuese mund e duhet te angazhohen e insistojne me shume per te permiresuar poziten e tyre ne organet drejtuese te sindikatave, por edhe ne administratat e shkollave e me gjere ne jeten shoqerore.

Qofte edhe me nje analize jo shume te thelluar te ketyre treguesve, dalin qarte disa nga drejtimet kryesore ku duhet te perqendrohet vemendja jone ne lidhje me kete ceshtje ne te ardhmen:

- Te perpunohen objektiva me te mira e me konkrete per te permiresuar imazhin e sindikatave te arsimit dhe per te shtuar numrin e anetareve te tyre nga radhet e grave,

- Te behen sa me shume aktivitete sensibilizuese per perfitimet dhe sherbimet qe ofron anetaresimi ne sindikata, me qellim qe, mundesisht, te gjitha grate te anetaresohen ne to,

- Te hartohen plane konkrete nga drejtueset e keshillave sindikale dhe komitetet e grave, per t'iu pergjigjur kerkesave dhe intersave te grave,

- Te sigurohet mbeshtetje sa me e

gjere brenda dhe jashte kolektivave te shkollave, nepermjet formave te larmishme dhe veprimtarive terheqese per grate mesuese.

II. DISA TE DHENA E KONKLUZIONE MBI MENDIMET E GRAVE DREJTUESE SINDIKALE DHE GRAVE MESUESE NE LIDHJE ME PROBLEMET QE KANE TE BEJNE ME MARDHENIET E PUNES DHE QENDRIMIN E KOMITETEVE TE GRAVE DHE SINDIKATAVE NDAJ TYRE

Mardheniet e punes, jane elementi me i rendesishem ne jeten dhe



veprimtarine e grave mesuese ne veprimtarine e tyre jetesore. Ato lidhen, jo vetem me jeten personale e familjare, por edhe me zhvillimin e sistemit arsimor dhe te ardhmen e vendit.

Eshte per kete arsye qe keto mardhenie kane zene pothuajse vendin kryesor edhe ne Anketimin per te cilin u diskutua ne kete Tryeze.

Per kete ceshtje eshte synuar qe te merren vecas opinionet e grave drejtuese lokale dhe grave mesuese, anetare ose jo te sindikatave.

119 gra drejtuese sindikaliste dhe 440 gra mesuese, anetare ose jo te

sindikatave te anketuara jane prononcuar se ne sindikatat perkatese jane ngritur probleme te marredhenieve te punes nga ana e grave mesuese.

Kater jane grupet e problemeve qe jane ngritur ne lidhje me kete ceshtje:

1- Permiresimi i kushteve te punes, perfshire gjendjen e klasave dhe bazes materiale ne kabinetet e shkollave, sigurimin e ngrohjes per periudhen e dimrit, permiresimin e masave per transportin e mesuesve e te nxenesve, krijimin e ambienteve te posacme per grate mesuese, sjelljen ne normalitet te numrit te nxenesve ne klasa, qe vazhdon te jete shume i larte, rishikimin e normes mesimore, e cila konsiderohet e larte, ceshtje keto qe jane ngritur nga shumica e grave te anketuara, sidomos

ne shkollat e Tiranës, Durrësit, Korçës, Elbasanit;

2- Problemet e rritjes se pagave dhe motivimi me i mire i mesuesve per punen qe bejne, vleresimi me i mire i performances se cdo mesuesi, te cilat, gjithashtu, jane ngritur nga shume gra mesuese, sidomos ne shkollat e rretheve Tirane, Shkoder, Kucove;

3- Sigurimi i vendit te punes dhe shmangia e largimeve nga puna ose transferimeve per arsye politike ose arsye te tjera qe nuk lidhen me kriteret ligjore dhe profesionale, ceshtje keto te ngritura sidomos ne disa shkolla te anketuara ne rrethin e Fierit;

4- Ulja e moshes se daljes ne pension per mesuesit, e cila konsiderohet e larte dhe thuajse e pamundur per t'u perballuar, sipas kerkesave te larta dhe nevojave ne rritje per arsim cilesor per te gjithë, ngritur nga shumica e shkollave te anketuara.

Eshte e rendesishme te analizohet se cili eshte mendimi i grave te anketuara ne lidhje me reagimin e sindikatave ndaj ketyre problemeve qe jane ngritur.

Vetem ne 47 raste kane reaguar sindikatat nga 119 te tilla qe jane ngritur nga ana e grave drejtuese, nderkohe qe sindikatat kane reaguat ne 200 raste nga 439 raste qe jane ngritur probleme te tilla nga ana e grave mesuese, kryesisht anetare ne sindikate.

Prapa eshte e qarte se ne kete drejtim duhet te punohet me mire nga te gjitha organet drejtuese te sindikatave, si edhe nga ana e komiteteve te grave per t'iu referuar me drejtperdrejte problemeve te mardhenieve te punes. Duhet te kemi parasysh gjithashtu, se ne i jemi referuar vetem reagimit, nderkohe qe treguesi me i drejtperdrejte eshte ndikimi per zgjidhjen e ketyre problemeve dhe vete zgjidhja.

III/ DISA TE DHENA E KONKLUZIONE MBI MENDIMET E GRAVE DREJTUESE SINDIKALE DHE GRAVE MESUESE NE LIDHJE ME PROBLEMET SOCIALE E TE KOHES SE LIRE TE GRAVE MESUESE DHE PUNEN E QENDRIMIN E KOMITETEVE TE GRAVE E SINDIKATAVE NDAJ TYRE

Problemet sociale dhe ato te kohes se lire zene nje vend te rendesishem ne jeten dhe veprimtarine e perditeshme te grave ne shkollat e jashte saj, prandaj ato kane terhequr nje vemendje te vecante ne Anketim.

Disa nga problemet sociale me

Vijon nga faqja 10

te rendesishme qe jane ngritur nga grate pjesemarrese ne anketim, ne lidhje me kete ceshtje jane:

- Niveli i pakenaqshem i jeteses, per shkak te te ardhurave te pamjaftueshme, rritjes se cmimeve e inflacionit dhe shtrenjtimit te kostos se jeteses,

- Problemet dhe veshtiresite qe krijohen per shkak te mungeses se energjise elektrike dhe ujit, gje qe e ngarkon se tepermi jeten familjare dhe shoqerore te grave,

- Puna e femijeve, ne disa raste edhe ngujimi i tyre per shkak te gjakmarrjes, sidomos ne zonen veriore dhe mundesite e kufizuara per nje arsimim cilesor per te gjithë,

- Cmimet e larta te librave artistike dhe mundesite e kufizuara per te pasur nje minimum te domosdoshem te tyre ne bibliotekat familjare,

- Problemet qe dalin ne lidhje me marredheniet shoqerore ne shkolle, marredheniet ne familje, perdorimi i dhunes ne disa raste, keqtrajtimi i femijeve etj.

Te dhenat tregojne se grate mesuese kane shume probleme sociale dhe i kane ngritur ato me shqetesim, por reagimi i sindikatave nuk ka qene ne nivelin e duhur. Per kete, shume mesuese gra pergjigjen ne pyetesor se kerkojne qe keshillat sindikale e komitetet e grave te mireorganizohen dhe te kene qellime te qarta ne misionin e vet, te kene objektiva konkrete dhe te organizojne pune efektive, ne menyre qe te zgjidhin probleme ne kohe dhe te krijojne mundesi edhe per te shtuar me tej anetaresine me gra sindikaliste.

Ne shume prej pergjigjeve te anketimit vihet ne dukje se ne lidhje me problemet e braktisjes se shkolles dhe eliminimin e punes se femijeve sindikatat kane bere nje pune shume te mire, duke arritur rezultate konkrete, sidomos ne kthimin e shume femijeve ne shkolle dhe duke shenuar permiresime te dukshme ne rezultatet ne mesime. Ishin grate mesuese ato

qe moren ne kujdestari e punuan me keta nxenes duke bere nje pune konkrete bazuar tek vecorite e sejcilit prej tyre. Po keshtu, shume mesuese gra kane dhene nje ndihmese shume te madhe per perparimin ne mesime te femijeve te ngujuar, duke zhvilluar ore mesimore individuale ne ambientet e tyre shtepiake.

Eshte e rendesishme qe nga 332 gra qe kane ngritur probleme shoqerore, 260 prej tyre kane pohuar se kane besim qe sindikatat mund te zgjidhin shume nga keto probleme, por ajo qe kerkohet eshte nje angazhim me i madh, konkret e rezultativ per keto probleme, duke i konsideruar ato si ceshtje te rendesishme sindikale.

Vend te rendesishem kane zene ne Anketim problemet e organizimit te kohes se lire nga ana e grave mesuese. Kjo eshte nje ceshtje shume e ndjeshme edhe per faktin se grate, krahas problemeve te punes, kane edhe detyrime te shumta familjare, te cilat sidomos ne kontekstin shqiptar, ne jo pak raste krijojne edhe probleme ne marredheniet familjare.

Pyetjes ne Ankete se "A diskutohet ne sindikate per kohen e lire te grave?" nga 119 drejtuese sindikale te intervistuar, i jane pergjigjur pozitivisht 57 prej tyre dhe nga keto, vetem 39 pohojne reagimin e sindikatave.

Ndersa lidhur me organizimin e aktiviteve ne kohen e lire nga ana e sindikatave, nga 119 drejtuese sindikale te intervistuar, i jane pergjigjur pozitivisht 95 prej tyre, duke permendur sidomos festat e ndryshme si 7-8 Marsi, daljet ne pension te kolegeve te tyre mesues, festat e fundvitit, per 5 tetorin, ditën boterore te mesuesit, ngjarje te shenuara si ditelindje etj.

Nga Anketimi del se per aktivite te shumta dallohen seksionet dhe komitetet e grave ne rrethet Tirane, Fier, Vlore, Korçe, Durres etj.

Ne lidhje me raportin midis aktiviteve qe lidhen me aftesimin profesional dhe argetimin gjate kohes se lire, pergjigjet e pyetjeve tregojne se rreth 20 perqind e zene aktivitetet qe

lidhen me kualifikimin profesional dhe rreth 15 perqind ato te argetimit. Qe ketej del se per te dyja llojet e aktiviteve grate mesuese duhet te gjejne forma me terheqese dhe komitetet e grave duhet te ndjekin konkrteisht punen per zgjerimin e games se ketyre aktiviteve.

Nga Anketimi del se duhet ende shume pune qe Keshillat Sindikale ne bashkepunim me Komitetet e Grave ne rrethe te bejne plane aktivitetesh ku te parashikojne, vec te tjerave, edhe takime, biseda me psikologe, mjeke specialiste, etj, per te cilat grate shfaqin gjithmone interes te vecante.

IV. DISA KONKLUZIONE NE LIDHJE ME MENDIMIN E GRAVE DREJTUESE SINDIKALE DHE GRAVE MESUESE PER KOMITETIN E GRAVE DHE SINDIKATAT

Per ndjekjen e problemeve qe lidhen me punen me grate, krahas seksioneve sindikale, FSASH dhe SPASH, duke punuar edhe ne kuadrin e Projektit me AOb/FNV, kane ngritur edhe struktura te posacme, sic jane komisionet apo komitetet e grave.

Statutet e sindikatave kane nene te vecanta ku parashikohet ngritja dhe funksionimi i ketyre strukturave, ne perberje te seksioneve sindikale. Ato kane te drejte statutore te bejne propozime zyrtare dhe te ndikojne ne marrjen e vendimeve ne seksione dhe ne organet drejtuese te seciles prej sindikatave.

Edhe nga Anketimi del se ne te nente rrethet e anketuara jane ngritur e funksionojne keto komitete dhe shume gra mesuese jane aktive ne vepriktarine e tyre.

Por nga anketimi del, gjithashtu, se keto komitete nuk njihen sa duhet nga grate sindikaliste. Rreth 485 gra, nga 650 te intervistuar, jane shprehur se kane dijeni per ekzistencen, funksionimin dhe rolin e ketyre strukturave, nderkohe qe rreth 405 prej

grave qe kane dijeni per to, pohojne qe te kene mendim pozitiv per punen, veprimtarine dhe rolin e ketyre komiteteve.

Pak a shume ne keto nivele eshte edhe mendimi i drejtuesve sindikaliste te anketuara.

Nga 105 prej atyre qe jane shprehur per kete problem, 22 i kane vleresuar shume mire, 46 i kane vleresuar mire dhe 37 jane shprehur se ato nuk funksionojne sic duhet.

Nga te dhenat e mesiperme nxjerrim konkluzionin se komitetet e grave akoma nuk po e luajne rolin e tyre si udheheqese e drejtuese te grave mesuese. Rrjedhimisht, del si detyre e rendesishme permiresimi i metejshem i punes per fuqizimin e ketyre organeve, per te ndihmuar ne zgjidhjen e

Ne Anketim vleresohet ndihmesa e vecante qe kane dhene ne kete drejtim edhe specialistet holandeze Claire Oostvriesland dhe Truy Kerperien, sidomos me keshillat e tyre shume praktike per domosdoshmerine e angazhimit te vete grave ne komitete per realizimin e synimeve te tyre me kembengulje.

V. ÇFARE PRESIN GRATE MESUESE NGA SINDIKATAT DHE KOMITETET E GRAVE

Duke iu pergjigjur pyetjes se cfare presin nga komitetet e grave dhe sindikatat, grate mesuese te anketuara kane shprehur mendime konkrete dhe interesante, disa prej te cilave jane:



problemeve qe dalin nga mesueset sindikaliste.

Nje pjese e madhe e grave te intervistuarra kane vleresuar punen e vecante qe kane bere sindikatat tona me grate mesuese, sidomos per trainimin dhe kualifikimin e nje pjese te mire te tyre, duke organizuar disa seminare ne rang kombetar, tematika specifike e te cilave ka qene puna me grate mesuese, si edhe ngritja dhe fuqizimi i komitetit te grave, gje qe ka ndikuar pozitivisht ne konsolidimin e ketyre komiteteve ne disa rrethe, si Tirana, Vlora, Kucova, Elbasani, etj.

- Te kete plane konkrete per veprimtarite e komiteteve te grave dhe te seksioneve sindikale me grate mesuese. Per hartimin e kalendarit vjetor te ketyre aktiviteteve, te merren mendime nga grate mesuese te keshillave sindikale. Keshtu zeri i grave do jete me i fuqishem.

- Te afishohen dhe te behen te njohura objektivat qe synohen te arrihen dhe te ndiqet ne proces puna per realizimin e tyre, sidomos nga komitetet e grave,

- Te vazhdojne te behen me shume trajnime, jo vetem me trajnueset, por

edhe me drejtueset ne nivel qarku e rrethi, me qellim qe te rritet numri i grave te afta per te perballuar detyrat e sindikatave,

- Te behen takime dhe aktivitete te tjera, me pjesemarrjen e anetareve te komiteteve te grave te rretheve qe jane prane njeri-tjetrit,

- Te behen me shume trainime per ngritjen profesionale per t'iu pergjigjur kerkesave dhe stadi aktual te zhvillimit te arsimit dhe te punohet per rritjen e rolit te grave sindikaliste ne menaxhimin dhe drejtimin e arsimit,

- Te insistojme per miratimin e Statusit te Mesuesit, ku nje vend te vecante te zene problemet specifike te grave mesuese,

- Te japim me shume mendime dhe te bejme propozime konkrete per permiresimin e legjislacionit ne lidhje me statusin e grave ne pergjithesi dhe te grave mesuese ne vecanti,

- Te shperndahet sa me shume Revista "Tribuna Sindikale" neper shkolla, sepse ka materiale me vlere edhe per punen me grate mesuese,

- Te pergatiten e shperndahen materiale propaganduese, fletpalosje, postera ku te behen te ditura aktivitetet e organizuara nga komitetet e grave ne rrethe.

Ky anketim shenoi nje hap te rendesishem perpara ne punen e dy sindikatave tona te arsimit. Ne kemi tani nje tablo reale te gjendjes per keto rrethe, por ne mund te nxjerrim konkluzione edhe per rrethet e tjera.

Duke marre takime e duke bere konsulta me nje numer kaq te madh grash, drejtuese te sindikatave tona ne shkolla e seksione, si edhe me shume gra mesuese, anetare ose jo te sindikatave, ne jo vetem njohem gjendjen dhe terhoqem mendime per punen e komiteteve dhe te sindikatave me grate mesuese, por, ne te njejten kohe, beme nje propagande te madhe tek anetaret e sindikates dhe me gjere tek grate mesuese per angazhimin e sindikatave per trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve te grave mesuese.

Sindikatat e arsimit dhe shoqata të tjera në Shqipëri së bashku në aktivitetet e Javës së Veprimeve Globale për Arsimin

Aktivitetet e Javës së Veprimeve Globale për Arsimin në Shqipëri këtë vit u organizuan më mirë dhe më masivisht krahasuar me vitet e tjera.

Si edhe në vitet e kaluara, FSASH dhe SPASH ishin pjesë e rëndësishme e Koalicionit Shqiptar për Arsimimin e Fëmijëve në Shqipëri, duke organizuar këto aktivitete të përbëra

dhe shpërndarja e Posterit Lokal, (i bazuar në Posterin Global), në 1 000 kopje, të përdorura si mjet propagande gjatë javës së Fushatës. Të dy sindikatat e arsimit, organizuan shpërndarjen e Posterave Lokale dhe materialeve të tjera të dërguara nga EI, veçanërisht në aktivitetet e organizuara në nivel

e cila pati shumë publicitet, gjithashtu, për shkak të fjalimeve të parlamentarëve që morën pjesë në këtë ndeshje, në lidhje me arsimimin, problemet e hasura dhe rolin e Parlamentit Shqiptar dhe Qeverisë.

3. Një Takim kombëtar mbi domosdoshmërinë e arsimimit të fëmijëve u organizua në 23 prill nga dy sindikatat e arsimit, FSASH dhe SPASH, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkences, me pjesëmarrjen e mësuesve, përfaqësuesve të sindikatave, fëmijëve, prindërve dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë dhe Drejtoritë Arsimore nga rajonet kryesore të vendit.

Më shumë se 60 drejtues lokal të sindikatës, nxënës dhe përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkences, drejtoritë arsimore, si dhe nga disa shkolla të Tiranës u mbledhën në Ministrinë e Arsimit dhe Shkences me rastin e aktiviteteve të Javës së Veprimeve Globale për Arsimin.

Zëvendës Ministri i Arsimit, Zoti Halit Shamata, përshëndeti përfaqësuesit dhe sindikatat për iniciativën dhe foli për angazhimin e të gjitha strukturave të Ministrisë dhe drejtorive arsimore lokale për të realizuar qëllimet e EFA-s në Shqipëri. Ai vlerësoi kontributin e FSASH dhe SPASH, veçanërisht për parandalimin e braktisjes së shkollës nga ana e nxënësve dhe eliminimin e punës së fëmijëve në Shqipëri, dhe foli mbi strategjinë e Ministrisë dhe institucioneve të tjera arsimore për të realizuar arsimim cilësor për të në Shqipëri.

Në emër të të dy sindikatave të arsimit, kryetari i FSASH, Zoti Xhafer Dobrush, foli mbi angazhimin e tyre, në lidhje me arsimimin për të gjithë dhe eliminimin e punës së



nga më shumë se 16 organizata dhe institucione, përfshirë Qendrën Për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri, CRCA dhe organizata të tjera ndërkombëtare dhe institucione në Shqipëri, duke përfshirë UNICEF, Save the Children Albania, IRCCRA, Fshati i Fëmijëve SOS, World Vision Albania, MEDPAK, Albanian Children's Alliance, Children Today, Vatra, Kisha Ortodokse shqiptare, Aleanca e Gjinive etj.

Disa nga aktivitetet më të rëndësishme të organizuara në kuadër të Koalicionit ishin:

1. Materiale të prodhuara dhe të shpërndara

Midis gjithë aktiviteteve të tjera të Javës së Veprimeve Globale për Arsimin në Shqipëri, ishte publikimi

qendror dhe në shumicën e shkollave që ishin më aktive në këto aktivitete, në Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Vlorë, Librazhd, Shkodër etj. Një artikull i gjerë u publikua në revistën "Tribuna Sindikale", ndërkohë që gazeta të tjera shkruan për aktivitetin e organizuar në këtë kuadër.

Një letër dhe një kopje e posterit iu dërgua me postë nga CRCA-së, në emër të Koalicionit, 140 parlamentarëve shqiptarë, duke u kërkuar atyre të kthehen në shkollë dhe të kontribuojnë për një edukim më të mirë të fëmijëve.

2. Një ndeshje futbollit ndërmjet fëmijëve dhe parlamentarëve, si një mundësi për ta për të treguar mbështetjen për Fushatën, u organizua në 23 prill 2008 në Tiranë,

fëmijëve, duke përmendur edhe disa nga aktivitetet e organizuara në kuadër të zbatimit të projekteve dhe Javës së Veprimeve Globale për Arsimin në Shqipëri dhe vlerësoi bashkëpunimin me Ministrinë dhe drejtoritë arsimore, që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatet e arritura gjatë këtyre viteve të fundit në Shqipëri.

Gazetarë të disa kanaleve televizive ndoqën dhe raportuan për ngjarjen në mediat përkatëse.

4. “Mësimi më i madh në botë”, në kuadrin e kesaj Jave, **ky leksion,** u mbajt në një numër të konsiderueshëm shkollash në Shqipëri më 23 prill në orën 9.00. Pas veprimtarive propogandistike të zhvilluara nga të gjithë anëtarët e Koalicionit dhe në mbështetje të tyre, Ministria e Arsimit dhe Shkencës qarkulloi një memo ne të gjitha drejtoritë arsimore në nivel lokal, si rezultat i se ciles llogaritet që rreth 11 000 – 12 000 mësues, nxënës, prindër dhe persona që ishin të angazhuar në Fushatë morën pjesë në këtë aktivitet, duke qenë të fokusuar në sigurimin e një arsimimi cilësor për të gjithë. Parlamentarë dhe përfaqësues nga Ministria dhe drejtoritë arsimore u kthyen në shkollë në bashkëpunim me nxenesit si edhe duke iu përgjigjur pyetjeve për angazhimin e tyre për të

siguruar që të gjithë të kenë arsimim cilësor.

5. Një konferencë për shtyp me prezantues të njohur televiziv, veçanërisht nga televizioni kryesor kombëtar, TVSH, u mbajt në 24 prill 2008 nën temën “Politikanët në shkollë

Hazizaj, lexoi njoftimin për shtyp, në emër të Koalicionit Shqiptar, dhe bëri shpjegimet e nevojshme në lidhje me pyetjet e gazetarëve.

Spiker të njohur të Televizioneve Shqiptare bënë deklaratat e tyre për nevojën e arsimit cilësor publik për të



– është koha për të mësuar”.

Rreth 15 kanale televizive dhe gazetarë nga gazetaret kryesore të Shqipërisë morën pjesë dhe transmetuan lajmin rreth kësaj ngjarjeje.

Drejtori i Qendrës për Të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri, CRCA, Zoti Altin

gjithë fëmijët si përgjegjësi e qeverisë dhe institucioneve të tjera arsimore.

Një dosje e veçantë me njoftimin për shtyp, si dhe postera dhe publikime të tjera nga të gjithë partnerët e Koalicionit, iu vu në dispozicion secilit prej përfaqësuesve të mediave në konferencën për shtyp.

Stavri Liko

DISKUTIM PER KODIN E ETIKES SE MESUESIT

Grupi i Punes i ngarkuar me hartimin e Draftit të Kodit të Etikës së Mesuesit organizoi në Hotel Tirana Internacional një takim me mesues, sindikaliste dhe drejtues të shkollave të mesme e 9 vjecare të Qytetit të Tiranës për të diskutuar për përmbajtjen e Draftit që ai ka përgatitur për Kodin e Etikës së Mesuesit.

Anetare të Grupit të Punes Tomi Treska, Albana Markja, Zenel Sina, Mirela Berisha dhe Xhafer Dobrushit bënë komente për pjesë të vecanta të Draftit të këtij Kodi.

Te pranishmit në takim u organizuan në tre grupe pune, dy prej të cilave me

mesues e sindikaliste dhe një grup me drejtues shkollash të mesme dhe 9 vjecare.

Secili grup diskutoi me interesim të vecante për përmbajtjen e Projektit dhe në seance plenare paraqiti vërejtje dhe propozime për përmirësimin e përmbajtjes së Kodit.

Propozime për përmirësime, saktësime dhe plotësime u bënë sidomos për marrëdhëniet mesues- nxënës, për marrëdhëniet mesues-mesues dhe mesues-drejtes e anasjelltash, për normat që duhet të karakterizojnë sjelljen dhe qëndrimin e mesuesit në komunitet, për mënyrën e veshjes dhe në përgjithësi

te paraqitjes së jashtme etj.

Te pranishmit u shprehën njezëri së hartimi dhe miratimi i një Kodi të Etikës së Mesuesit plotëson një boshllëk në teresinë e akteve dhe dispozitave që rregullojnë jetën mesimore dhe gjithë veprimtarinë e mesuesve e të drejtuesve të arsimit në shkollë e jashtë saj. Kodi i Etikës së Mesuesit, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe normative që rregullojnë procesin e mesimdhënis dhe të arsimimit të brezit të ri, shënon një hap përpara dhe përben një bazë të shëndoshe për përmirësimin e mëtejshëm të mesimdhënis dhe rritjen e rolit edukues të shkolles në vendin tonë.

MBI REFORMEN E SISTEMIT TE ZHVILLIMIT PROFESIONAL TE MESUESVE

(Vijon nga numri i kaluar)

Reforma e sistemit arsimor para-universitar parashtrohet kërkesa të reja edhe në fushën e zhvillimit profesional të mesuesve. Për t'u dhënë mundësi lexuesve të Revistës "Tribuna Sindikale", sindikalisteve dhe gjithë mesuesve që të njihen me këto kërkesa me të cilat ata do të përballen, Redaksia ka botuar në dy numra të kaluar pjesë nga reforma e sistemit të zhvillimit profesional të mesuesve. Ne vijim, në këtë numer, po botojmë kërkesat që lidhen me kreditet për njohuritë, kreditet për aftësitë praktike dhe kreditet për arritjet e nxënësve.

KREDITET PËR NJOHURITË

1. Pjesa e pikëve për njohuritë mësuesi i siguron nga pikët e grumbulluara në provimet e teorisë.

2. Qëllimi i provimit nuk është të rivlerësojë njohuritë universitare. Provimi, në përgjithësi, teston informacionin e ri të domosdoshëm për suksesin e mësuesit.

3. Njohuritë në ndahen në disa blloqe. Këto mund të jenë:

- Njohuri shkencore të lëndës,
- Njohuri të zhvillimit moshor të fëmijëve-nxënës;
- Njohuri pedagogjike si teoritë e mësimdhënies-mësimnxënies, vlerësimi diagnostik, etj).

4. Njohuritë shtjellohen kryesisht trajtën e modulit. Moduli përmban dhe kompetencat (objektivat e arritjeve) të mësuesit me përfundimin e modulit. Një modul mund të parashikojë dhe sëanca simulimi e praktike në kushtet e klasës.

5. Modulet janë dy llojesh: me tematikë të detyruar dhe me tematikë me zgjedhje në një menu të detyruar temash.

6. Ka një raport të caktuar në mes pikëve për tematikën e detyruar dhe me zgjedhje. P.sh. mund të kërkohej që 70% e pikëve të grumbullohen nga trajnimet me tematikë të detyruar, kurse 30% nga ato me zgjedhje.

7. Tematika e trajnimeve të detyruara dhe me zgjedhje miratohet nga MASH me propozimin e QTKA-s dhe mbështetet në standardet e mësuesit në përgjithësi dhe posaçërisht në standardet e secilës shkallë.

8. Mësuesi është i detyruar të trajnohet në modulet me tematikë të detyruar dhe në një numër të caktuar modulesh me zgjedhje.

9. Mësuesi jep dy lloj provimesh për njohuritë: Provimet për modulet dhe provimin përfundimtar.

10. Ka një raport të caktuar në mes pikëve për modulet dhe për provimin përfundimtar. P.sh. 50% të pikëve mësuesi i grumbullon nga provimet për modulet dhe 50% nga provimi përfundimtar.

11. Testet e provimeve për modulet hartohen nga agjencitë që kanë kryer trajnimet.

12. Provimet për modulet administrohen nga agjencitë që kanë kryer trajnimet.

13. Mësuesi pranohet në provimin përfundimtar për një shkallë të caktuar të karrierës nëse ka marrë një numër të caktuar pikësh në provimet e moduleve.

14. Për provimin përfundimtar për një titull karriere QTKA përshkruan përmbajtjen e mundshme të testit dhe tregon përqindjet e pikëve të testit për secilën linjë të përmbajtjes lëndore.

15. Testi i provimit përfundimtar është i standardizuar për një titull të caktuar dhe një lëndë të caktuar dhe zhvillohet në një datë të njëjtë në të gjithë vendin dhe hartohet nga QTKA.

16. Provimi përfundimtar administrohet nga punonjës jashtë qarkut ku zhvillohet provimi.

17. Qortimi dhe vlerësimi i provimeve kryhet nga vlerësues në Tiranë pranë QTKA.

18. Shuma e pikëve (krediteve) për njohuritë ka një prag minimal nën të cilin mësuesi nuk e fiton titullin që pretendon edhe sikur në aftësitë praktike dhe rezultatet e nxënësve të marrë pikët e mjaftueshme.

KREDITET PËR AFTËSITË PRAKTIKE

19. Pjesa e pikëve për aftësi praktike në zhvillimin e mësimin, mësuesi i siguron nga vëzhgimi i një numri të caktuar orësh mësimore përgjatë disa viteve, në periudhën ndërmjet dy titujve, i cili kryhet nga inspektorët qendrorë ose lokale,

20. Inspektorët lokalë dhe qendrorë inspektojnë me përparësi mësuesit që kanë aplikuar për ngjitje në shkallët e karrierës.

21. Mesatarisht mësuesi - aplikant vëzhgohet një herë në vit.

22. Vëzhgimi i aplikantit kryhet sipas janë formati dhe vlerësimi i mësuesit bëhet më pikë sipas disa zërave.

23. Vlerësimi i inspektorëve kategorizohet në "Shumë mirë", "Mirë", "Mjaftueshëm", "Dobët".

24. Tre vlerësime "dobët" shtyjnë për një vit afatin e aplikimit për titullin përkatës.

25. Vlerësimi të jashtëm i nënshtrohen edhe mësuesit që kanë fituar titullin përfundimtar.

26. Për tre vlerësime "dobët", mësuesi, që kanë fituar titullin përfundimtar, është i detyruar të ndjekë module të caktuara trajnimi dhe pasi i fiton kreditet e tyre, vlerësohet përsëri për aftësitë praktike.

27. Nëse edhe më pas mësuesi, që kanë fituar titullin përfundimtar, vlerësohet qoftë edhe një herë të vetme "dobët", i anulohet shtesa e pagës për titullin derisa ta rifitojë me procedurat e zakonshme për fitimin e këtij titulli.

28. Si dëshmi të aftësive praktike mund të shërbejnë edhe botime të mësuesit për risi konkrete e të suksesshme në arritjet e nxënësve.

29. Inspektori, nëndrejtori pedagogjik, kryetari i ekipit lëndor, trajnohen posaçërisht për vëzhgimin e orës mësimore dhe certifikohen për ta ushtruar vëzhgimin.

KREDITET PËR ARRITJET E NXËNËSVE

30. Pjesa e pikëve për arritjet e nxënësve mësuesi i siguron nga pikët e grumbulluara në testimet e standardizuara të nxënësve përgjatë disa viteve, nga rezultatet në provimet e maturës shtetërore ose të lirimimit dhe në survey kombëtarë.

31. Testet e standardizuara zhvillohen nga inspektorët jo të qarkut përkatës.

32. Mësuesi vlerësohet me pikë për:
- Rezultatet e nxënësve të tij për standardet minimale lëndore të arritjeve,
- Diferencën ndërmjet notave shkollore të nxënësve të tij me notat e marra gjatë testeve të jashtme.

33. Sukseset e nxënësve në olimpiada ose konkurse të tjera jo brenda shkollës kontribuojnë në pikët për arritjet e nxënësve.
34. Vlerësimi i mësuesit për arritjet e nxënësve kategorizohet në "Shumë mirë", "Mirë", "Mjaftueshëm", "Dobët".

35. Tre vlerësime "dobët" shtyjnë për një vit afatin e aplikimit për titullin përkatës.

36. Për tre vlerësime "dobët", mësuesi, që kanë fituar titullin përfundimtar, është i detyruar të ndjekë module të caktuara trajnimi dhe pasi i fiton kreditet e tyre, vlerësohet përsëri për arritjet e nxënësve.


37. Nëse edhe më pas mësuesi, që kanë fituar titullin përfundimtar, vlerësohet qoftë edhe një herë të vetme "dobët", i anulohet shtesa e pagës për titullin derisa ta rifitojë me procedurat e zakonshme për fitimin e këtij titulli.

38. Inspektori dhe drejtuesit e shkollës trajnohen posaçërisht për vlerësimin e mësuesit sipas arritjeve të nxënësve të tij dhe certifikohen për këtë.

Të reja shkencore

PA SHENJA

E dëgjuat barsaletën për zyrën pa letër? Tani që e dimë që ky është thjesht një mit, shkencëtari Paul Smith,



në Qendrën e Kërkimeve "Xerox" në Kanada, ka bërë një zbulim të madh me "Letrën që Fshihet". Letra është e mbështjellë me një material që ndryshon ngjyrë kur ekspozohet në dritë dhe teksti projektohet në të duke përdorur një printer pa bojë. Teksti zhduket për 24 orë, kështu që ju mund ta përdorni letrën përsëri, kur të dëshironi.

Për momentin është vetëm një prototip.

GOMA QE TAKON SHINAT DMV (ADMP)

Është në fakt një akronim i këndshëm në disa vende të botës. Në muajin prill të këtij viti Kompania e hekurudhave JR Hokkaido filloi të testojë Automjetin me Dy Mënyra Përdorimi në një rrugë piktoreske përgjatë detit të Okhotsk, në prefekturën më të madhe të Japonisë. Kur mikrobuzi i verdhë gazmor ecën



jashtë shinave, në zonat rurale, ai rihap gomat dhe fillon ecjen normale në rrugë.

Ky kthim bëhet për 10 sekonda.

Qëllimi fillestar i përdorimit është për turizëm. Testet parashikohet të përfundojnë në fillim të nëntorit.

I VERBUARI NGA DRITAT

Kërkimi për një armë jo vdekjeprurëse është më urgjent tani që vazhdojnë vdekjet nga armët shkatërruese.

Drita Bllokuese, e krijuar nga Departamenti i Brendshëm i Sigurisë,



është një alternativë e re. Kur policët drejtojnë këtë pajisje tek sytë e dikujt, drita me intensitet shumë të lartë, duke pulsuar në intervale të ndryshme kohe, do të bëjë që i dysuari të verbobet dhe të trulloset përkohësisht. Kjo pajisje do të jetë e disponueshme që nga fundi i këtij viti.

Këshilla praktike

KATËR GËNJESHTRA TIPIKE NË PUNË

Gënjeshtra të vogla dhe, rastësisht, të mëdha, janë pjesë e kulturës në vendin e punës, tamam si mbledhjet e mërzitshme dhe kolegët llafazanë. Një ditë pune 100% pa gënjeshtra është e rrallë. Jo gjithmonë qëllimet janë të këqija, shpesh ndodh të gënjejmë për të kënaqur të tjerët, edhe në kurrizin tonë. Por, duke gënjyer, nuk krijohet një ambient i përshtatshëm pune. Për të sjellë më shumë ndershmëri në vendin e punës, ne vijim janë katër gënjeshtra të cilat të gjithë i themi dhe le të tregojmë si t'i përballojmë më mirë situatat e vështira që krijohen prej tyre.

1. "Do të isha i kënaqur"

Mendoni sa shume i keni shqiptuar fjalët "Do të isha i kënaqur" për të bërë diçka. Kur ka qenë e sinqertë kjo fjali? Kur një supervisor ose koleg ju cakton më shumë punë, ndërkohë që ju po punoni me gjera të tjera që kanë një afat për të respektuar, shpesh nuk dini si t'i refuzoni pa humbur vendin e punës.

Nëse pranoni një detyrë dhe thoni që do ta kryeni, shefi juaj pret që të mbani fjalën. Prandaj, nëse një detyrë e re pengon zhvillimin e punës suaj normale, kërkoni shefit

të merreni me punën që ka më shumë prioritet në mënyrë që të jeni në gjendje të respektoni afatet. Ai mund të ketë harruar sa shumë punë keni dhe sa urgjente janë.

2. "Jo, nuk kam asnjë pyetje"

E kujt nuk i ka ndodhur që t'i caktojnë një detyrë që nuk ka asnjë kuptim, por, kur shefi pyeti nëse kishit ndonjë pyetje, ju qëndruat në heshtje? Për më tepër, ju nuk doni të jeni ai që nuk e kupton çfarë po ndodh.

Nëse keni pyetje dhe ato ndikojnë në aftësinë tuaj për të kryer një punë të mirë, do të ishte e nevojshme të gjeni përgjigjet sa më shpejt. Fillojeni pyetjen tuaj duke thënë që doni thjesht të siguroheni që e kuptuat gjithçka tamam.

3. "Nuk më ra alarmi"

Ndonjëherë është e vërtetë që alarmet nuk bien, por shumicën e rasteve jeni ju ata që i fikni sapo fillojnë dhe e gjeni veten akoma të shtrirë në orën kur duhet të ishit rrugës për në punë.

Të pranosh është më mirë. Nëse kjo gjë nuk ndodh shpesh, nuk është ndonjë problem i madh.

Përgatituni të shpiegoheni nëse ky problem ndodh gjithmonë. Ndonjëherë nuk është e nevojshme të flisni shumë. Mjafton thjesht një frazë "Më vjen keq që erdha vonë, me falni" dhe më pas t'u ktheheni punëve.

4. "Jam mirë me planin"

Kur keni ndonjë afat për të dorëzuar një punë, duhet të jeni të interesuar të ndiqni planin për të mos u stresuar në momentet e fundit. Por shumë shpesh ndodh që të filloni projektin dy ditë para përfundimit të afatit. Kur shefi kalon për të parë si po shkon puna, ju fshini djersën nga balli dhe thoni që gjithçka po shkon sipas planit.

"Po punoj" mund të jetë një përgjigje më e mirë. Kjo përgjigje lë të kuptojë që i jeni futur punës, pa gënjyer për atë që keni arritur. Megjithatë mund të mendoni se nuk ka ndonjë dallim për aq kohë sa puna dorëzohet në kohë, mund t'ju duhet një këshillë pak para përfundimit dhe të tjerët do kuptojnë që keni gënjyer, nëse pyesni për diçka të cilën kishit thënë se e kishit mbaruar.

Përgatiti faqen Eriona Vangjeli

TRIBUNA SINDIKALE

